

Nr. regj. 14831/2012

Dep. DPK/DTP	03-2728/12
02	02.08.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me procesmbajtësen Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Osman(Xhemail)Ismajli, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 25.07.2012 morri këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Osman(Xhemail)Ismajli, i lindur më 10.02.1949 në Prishtinë, me vendbanim në Rrugën "H. Petërsen", kati I, Hyrja 1, nr. 6, në Prishtinë, jurist, Prodekan për mësim në Fakultetin Juridik, në Prishtinë, ka të kryer Fakultetin juridik, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse si zyrtarë i lartë publik, Prodekan për mësim në Fakultetin Juridik, në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë deri në afatin e fundit ligjorë 31 mars 2012, në Agjencinë kundër korrupsionit, sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, Nr. 04/L-050, -

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5, 6 dhe neni 8 ndëshkuar me nenin 17 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, andaj i shqiptohet

D Ë N I M

Me gjobë në shumë prej 1000(njëmijë)€, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Paga bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30(tridhjetë) ditësh.** Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga **5 €**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën nr. 01-1614/2012 me datë 02.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartcekur për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se është informuar për deklarinim vjetorë të pasurisë përmes pikës kontaktuese dhe çdo vjet pasi që tre vite është zyrtarë i larë ka bërë deklarinim e pasurisë, por për shkak të gjendjes së dobët shëndetësore në atë kohë, nuk e ka bërë deklarinim me kohë të pasurisë, gjykatës ia ka prezantuar një raport mjekësor si provë se nuk ka qenë mirë me shëndet poashtu gjykatës ia prezanton Vërtetimin me nr. Protokollit 03/3429 të datës 12.04.2012, se ka deklaruar pasurinë më vonë pasi që ka bërë më mirë me shëndet, lut gjykatën ta ketë parasysh këtë fakt. Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi të deklaratës së të pandehurit, vlerësimi të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë pasi që më afatin e paraparë ligjor deri 31.03 2012, nuk ka bërë deklarinim e pasurisë ashtu si e parasheh ligji në fuqi. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë, andaj i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 14831/2012, më datë 25.07.2012

Gjyqtaria

Azra Cakalli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.